URDHËR
Nr.605, datë 29.12.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË CIKLIT TË TRETË, TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MATEMATIKE DHE TË INXHINIERISË FIZIKE, TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë, të Doktoratës, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe të Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, në vitin akademik 2010-2011, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në inxhinieri matematike;

b) Doktoratë në inxhinieri fizike.

2. Programet e studimeve të Doktoratës, në Inxhinieri Matematike dhe në Inxhinieri Fizike, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe të Inxhinierisë Fizike të UPT-së, zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike.

3. Në përfundim të programeve të studimeve të Doktoratës, në Inxhinieri Matematike dhe në Inxhinieri Fizike, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe të Inxhinierisë Fizike të UPT-së, lëshohet diplomë për gradën shkencore "Doktor" (Dr.).

4. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të MASH-it dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj